



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2020:176024

Datë: 30.03.2024

Numri i dokumentit: 05528916

KPPP.nr.272/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit “Dorofix” Sh.P.K., me seli në fshatin Gllokoc, Stankoc, Komuna e Drenasit, me NRB: 811168146, kundër debitorit N.P.N “HOXHA” me seli në Prizren, me NRB: 811307695, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.G. avokate nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.1100/2020 të datës 20.11.2020, të Përbaruesit Privat Fatos Shatri, me seli në Pejë, jashtë seancës me datën 19.03.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.P.N “HOXHA” me seli në Prizren, SHFUQIZOHET Urdhri Përbarimor P.nr.1100/2020 i datës 20.11.2020, i nxjerrë nga Përbaruesi Privat Fatos Shatri.

**A r s y e t i m**

Përbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.1100/2020 të datës 20.11.2020, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.196/2019 të datës 23.07.2019, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin, që vullnetarisht të bëjë pagesën e borxhit në shumën prej 672.00 Euro, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, për shkak se kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përbarim mbi bazën e

faturës së bashkangjitur, dhe nuk është plotësuar kushti për të kërkuar kredinë. Më tej ka theksuar se përpilues i propozimit për përmbnim ishte vetë Përmbnuesi ngase propozimi përmban logon e Përmbnuesit, dhe kjo përmbn shkelle të nenit 323 dhe 324 të LPP-së. Ka shtuar se nga përmbajtja e faturës rrjedh se materiali i faturuar është i periudhës kohore qershor, korrik, gusht 2019, dhe në këtë periudhë nuk ishte krijuar asnjë raport detyrimi kreditor-debitor. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi dhe të abrogohet urdhri për përmbnim.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në Pizren, me aktvendimin PPP.nr.952/2020 të datës 15.04.2022, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit N.P.N “HOXHA”, dhe e ka lënë në fuqi urdhrin përmbnimor P.nr.1100/2020 të datës 20.11.2020 të Përmbnuesit Privat.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.696/23 të datës 31.01.2024 e ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit, duke anuluar vendimin e shkallës së parë PPP.nr.952/2020 të datës 15.04.2022, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje . Kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelle thelbësore të dispozitave të procedurës përmbnimore dhe kontestimore me rastin e vendosjes, dhe e ka udhëzuar që në riprocedurë t’i evitohet shkelle e dispozitave të procedurës përmbnimore nga neni 38 par.1 dhe 2, dhe nenit 43 të LPP-së.

Gjykata në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke i referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbnimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbnimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbnimor duhet të anulohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbnimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbnim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbnjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për*

*përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*".

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarrim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata gjeti se kreditori propozimin për përmbarrim të datës 20.11.2020 e ka bazuar në faturën nr.196/2019 të datës 23.07.2019, ndërsa propozimit i ka bashkëngjitur një faturë tjetër, përkatësisht faturën nr.180/2019 të datës 10.07.2019, pra në rastin konkret është treguar objekti i pasaktë i përmbarrimit.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim, ndërsa organi përmbarrues - Përmbarruesi Privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se "*Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafi 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore*", gjykata shfuqizoi urdhrin përmbarrimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.272/24, më datë 19.03.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.